

LIGJ
Nr.8097, datë 21.3.1996

**PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË
KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË
SHTETIT**

(Ndryshuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; nr. 9061, datë 8.5.2003; nr. 9827, datë 5.11.2007; nr. 9990, datë 15.9.2008; nr. 27/2015, datë 26.3.2015; nr. 166/2020, datë 23.12.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

(ndryshuar pika 8 dhe 9 me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; shtuar fjalë në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” të pikës 9 me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003; shtuar fjalë në shkronjën “a” të pikës 8 me ligjin nr. 9827, datë 5.11.2007 shtuar fjalë në shkronjën “b” të pikës 8 me ligjin nr. 9990, datë 15.9.2008; bigen fjalë në pikën 7, shtuar fjalë në shkronja “a”, “b” të pikës 8, shtuar pika 11 dhe 12 me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015; ndryshuar pika 7, shtuar funksione në shkronjën “a” dhe “b” të pikës 8, shfuqizuar funksion në shkronjën “b” të pikës 8, shtuar funksione në shkronjën “a” dhe “d” të pikës 9, shtuar pika 11 me ligjin nr. 166/2020, datë 23.12.2020)

1. Me termin “Ligj për sigurimet shoqërore” do të kuptohet ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Me termin “Sigurim shoqëror i detyrueshëm” do të kuptohet sigurimi sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Me termin “Kushtetuese” do të kuptohet legjislacioni kushtetues.

4. Me termin “Përfitime shtetërore suplementare” do të kuptohen përfitimet që jepen sipas këtij ligji.

5. Me termin “Vite shërbimi” do të kuptohen vitet e punës së kryer në një nga funksionet që burojnë nga Kushtetuta ose një nga detyrat në administratën publike, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

6. Me termin “Aksident në shërbim” do të kuptohet ndryshimi i gjendjes shëndetësore (i njohur nga KMCAP sipas ligjit për sigurimet shoqërore), ose vdekja për shkak dhe gjatë kryerjes së funksionit a detyrës (për këto të fundit sipas përkufizimeve të dhëna në këtë nen).

7. Me termin “pagë referuese” kuptohet paga e muajit më të fundit, sipas legjislacionit në

fuqi që zbatohet për atë funksion a detyrë.

Për funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe për funksionet, paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, me termin “pagë referuese” kuptohet:

a) për personat, të cilët kanë vite shërbimi deri më 31.12.2018, pavarësisht datës së lindjes të së drejtës për përfitim, paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion apo detyrë, sipas legjislacionit në fuqi, deri në datën 31.12.2018;

b) për personat, të cilët kanë vite shërbimi pas datës 1.1.2019, paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion, sipas legjislacionit në fuqi, në momentin e lindjes të së drejtës për përfitim, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës;

c) për personat, të cilët kanë vite shërbimi para dhe pas datës 31.12.2018, paga referuese për periudhën e shërbimit është paga mesatare mujore referuese që llogaritet si raport i shumës së pagave referuese të të gjitha funksioneve e detyrave që kanë gëzuar personat, respektivisht sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, me shumën e muajve që njihet si periudhë shërbimi për të gjitha funksionet e detyrat, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës.

Paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare dhe e pagesës kalimtare.

8. Në termin “Grupi i parë” do të përfshihen:

a) Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Këshillit të Ministrave, Zëvendëskryetarët e Kuvendit, Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, ministrat, Zëvendëskryetari i Kuvendit dhe të barazuar me ligj me ta, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisioneri Publik, Kryetar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Drejtues i Strukturës së Posaçme të Antikorrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

b) Deputetët e Kuvendit, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe Avokati i Popullit, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Gjeneralët e Forcave të Armatosura dhe punonjësit e Policisë së Shtetit të rolit madhor, Gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Komisioner i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës.

9. Në termin “Grupi i dytë” do të përfshihen:

a) Sekretarët e Shtetit, zëvendësministrat, zëvendësprokurorët e Përgjithshëm, si dhe personat e tjerë të barazuar me ta, sekretarët e përgjithshëm dhe funksionarët politikë pranë Presidentit, Kuvendit, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetari i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror, Këshillit të Ministrave, ministrive, institucioneve qendrore buxhetore, prefekturave, këshillave të rretheve, këshillave të qarqeve, bashkive dhe personave të tjerë të barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave, Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kancelar i Komisionerit Publik, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Sekretar i Përgjithshëm

në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, magistrat, pedagog i brendshëm në Shkollën e Magistraturës.

b) Personat që kryejnë detyra në administratën e Presidentit, të Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore buxhetore, të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, gjykatave të apelit, prokurorive të rretheve, prefekturave dhe të pushtetit vendor dhe personave të tjerë të barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

c) Personeli drejtues ku do të përfshihen: drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve, si dhe personat e tjerë të barazuar me ta, në funksion, personat të cilët punojnë në organet drejtuese të pushtetit vendor dhe në funksione të tjera drejtuese, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

d) Personeli specialist ku do të përfshihen specialistët dhe personat e tjerë të barazuar me ta në funksion, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave, Këshilltar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Këshilltar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Këshilltar i Komisionerit Publik, Kancelar në Shkollën e Magistraturës, punonjës të tjerë të barazueshëm me ta, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Në termin “Persona të punësuar” do të përfshihen gjithë personat që janë përcaktuar në pikat 8 dhe 9 të këtij neni.

11. Me termin “pagesë kalimtare” kuptohet pagesa që përfitojnë personat, subjekt i këtij ligji, pas ndërprerjes së funksionit ose kur punësohen në një funksion me pagë më të ulët se paga pararendëse. Për efekt të këtij ligji, dorëheqja, alternimi i funksionit titullar me anëtar brenda institucionit nuk konsiderohet ndërprerje e funksionit.

12. Në kuptim të pikës 9, të këtij neni, institucionet qendrore buxhetore, që do të përfshihen në këtë skemë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të jepen përfitime shtetërore suplementare si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror për personat e grupit të parë dhe të dytë.

Neni 3

Personat e mbrojtur

Përfitojnë nga ky ligj personat që përcaktohen në nenin 1.

Neni 4

Financimi

Përfitimet shtetërore suplementare që jepen sipas këtij ligji financohen:

a) nga buxheti i shtetit;

b) nga kontributi që derdhin personat e punësuar.

Neni 5

Masa e kontributeve

(ndryshuar me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Kontributet, që paguajnë personat e punësuar në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, janë:

- a) 5 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të parë;
- b) 4 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji;
- c) 3 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “d”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji.

Neni 6

Pagesa e kontributeve

Kontributet paguhen çdo muaj në fondin e sigurimit shtetëror suplementar. Afati i derdhjes është jo më vonë se fundi i muajit pasardhës.

KREU II

PËRFITIMET

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

PJESA E PARË

PAGESË KALIMTARE

Neni 7

(shtuar paragrafë pas paragrafit të tretë me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar tre paragrafët e parë dhe paragrafi i parafundit me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003; shtuar fjalë në paragrafin e parë, e dytë, e tretë, ndryshuar fjalë në paragrafin e pestë, ndryshuar paragrafi i shtatë me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015; zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 166/2020, datë 23.12.2020)

Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 8 të nenit 1, pas pas ndërprerjes së funksionit, u jepen tri paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “b” të pikës 8 të nenit 1, pas ndërprerjes së funksionit, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 9 të nenit 1, pas pas ndërprerjes së funksionit, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personat, të cilët gjatë periudhës së përfitimit të pagesës kalimtare janë të punësuar në një funksion kushtetues, që përfshihet në këtë ligj, pas ndërprerjes së funksionit, do të marrin pagesë kalimtare vetëm për atë periudhë shërbimi në funksion, gjatë së cilës nuk janë trajtuar edhe me pagesë kalimtare nga funksioni paraardhës.

Periudha, gjatë së cilës personat nuk janë të punësuar dhe përfitojnë pagesë pas ndërprerjes së funksionit të fundit dhe pagese kalimtare, njihet si periudhë sigurimi për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, familjar dhe invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë

11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kontributi i sigurimit të detyrueshëm shoqëror për këta persona derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore nga buxheti i shtetit.

Në rastet kur përfituesi punësohet, brenda periudhës së përfitimit të pagave të funksionit të fundit apo të pagesës kalimtare, masa e pagesës mbi pagën e re është një kompensim deri në nivelin e pagës referuese të funksionit, por në çdo rast ajo nuk mund të jetë më shumë se paga e funksionit të fundit apo pagesa kalimtare e tij.

Në rastet kur gjatë trajtimit me pagesë kalimtare lind e drejta për një përfitim nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, përfituesi nga ky ligj ka të drejtën e zgjedhjes së njërit prej tyre.

PJESA E DYTË PENSIONE SHTETËRORE SUPLEMENTARE

Neni 8

Kushtet e përfitimit për grupin e parë

(shtuar fjalë në shkronjën “a” të pikës 2, shtuar paragraf pas pikës 2/b me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; shtuar pika 3 në paragrafin e parë, shfuqizuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Kushtet e përfitimit për personat e grupit të parë, sipas këtij ligji, janë:

1. Të kenë mbushur moshën 60 vjeç ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit për sigurimet shoqërore të detyrueshme. Duke filluar nga data 1.1.2032, mosha e përfitimit rritet me nga 6 muaj për çdo vit, deri në arritjen e moshës 63 vjeç.

2. Të kenë periudha të njohura shërbimi në një nga funksionet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 8, të nenit 1.

3. Të ketë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

Neni 9

Masa e pensionit

(shtuar shkronja “c” në paragrafin e parë me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015; shtuar paragraf me ligjin nr. 166/2020, datë 23.12.2020)

Masa e pensionit shtetëror suplementar është:

a) për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, 25 për qind e pagës referuese, edhe nëse periudha e shërbimit është më e vogël se dy vjet, dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbimi mbi dy vjet;

b) për grupin e parë, përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 8, të nenit 1, përjashtuar personat e përmendur në shkronjën “a”, të këtij neni, 25 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar në masën 1 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi;

c) për grupin e parë, përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 8, të nenit 1, 20 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar, në masën 0,8 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi.

Masa e pensionit nuk duhet të jetë më e madhe se:

a) 60 për qind e pagës referuese për personat e grupit të parë, përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 1;

b) 50 për qind e pagës referuese për personat e grupit të parë, përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 1.

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese mesatare të funksioneve.

Për personat, të cilët kanë kryer funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për funksionet, paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, masa e pensionit llogaritet sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, por llogaritja e përfitimit për periudhat e shërbimit të kryera nga individët dhe të njohura si të tilla nga ky ligj bëhet sipas pagave referuese respektive, të përcaktuara në pikën 7 të nenit 1 të këtij ligji.

Neni 10

Kushtet e përfitimit për grupin e dytë

(shtuar paragraf me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Kushtet e përfitimit për personat e grupit të dytë, sipas këtij ligji, janë:

a) të kenë kryer 35 vite shërbimi në detyrat ose funksionet e parashikuara nga ky ligj; ose

b) të kenë arritur moshën për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ose

c) para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e sipërpërmendura, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

Neni 11

Masa e pensionit

(ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015; shtuar paragraf me ligjin nr. 166/2020, datë 23.12.2020)

Masa e pensionit shtetëror suplementar në kushtet e nenit 10 është:

a) për personat e grupit të dytë, sipas shkronjës “a”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,5 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

b) për personelin drejtues të grupit të dytë, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,3 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

c) për personelin specialist të grupit të dytë, sipas shkronjës “d”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,1 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi.

Pensionin shtetëror suplementar maksimal, sipas këtij neni, nuk duhet të jetë më i madh se 40 për qind e pagës referuese.

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese të funksionit.

Për personat, të cilët kanë kryer funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për funksionet paga e të cilëve referohet te ligji i sipërcituar, masa e pensionit

llogaritet sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, por periudhat e shërbimit të kryera nga individët vlerësohen sipas pagave referuese respektive, të përcaktuara në pikën 7 të nenit 1 të këtij ligji.

PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE FAMILJARE

Neni 12

Kushtet e përfitimit

Përfitojnë pensione familjare nga personi që vdes dhe që përfitonte ose kishte kushtet për pension shtetëror suplementar sipas këtij ligji, këta persona në ngarkim:

- bashkëshorti pasjetues,

- jetimi

dhe kur kanë plotësuar kushtet për pension familjar sipas ligjit për sigurimet shoqërore.

Neni 13

Masa e pensionit

(zëvendësuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003)

Masa e pensionit në kushtet e nenit 12 është:

a) 50 për qind për bashkëshortin pasjetues dhe

b) 25 për qind për jetimin.

Kur nuk merret pensioni i parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni, masa e pensionit për jetimin është vetëm 50 për qind.

Në çdo rast masa e pensionit suplementar familjar nuk mund të jetë më e lartë se pensioni suplementar që kishte ose i takonte të përfitonte mbajtësi i familjes.

Neni 14

Personat që aksidentohen në shërbim dhe deklarohen invalidë të përhershëm, sipas ligjit për sigurimet shoqërore, përfitojnë pension shtetëror suplementar në masën 40 për qind të pagës referuese, pavarësisht nga koha e punës në funksionet a detyrat sipas përkufizimeve të nenit 1.

KREU III

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 15

(shtuar paragraf me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; shtuar fjali në fund të paragrafit të parë me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003; shtuar fjalë në paragrafin e parë, shtuar dy paragrafë pas paragrafit të dytë ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Vite shërbimi për efekt përfitimi nga ky ligj do të njihen vitet e punuara në funksionet apo detyrat e përcaktuara nga ky ligj nga data 1 prill 1991. Periudhë shërbimi, për efekt përfitimi nga ky ligj, pas 1 prillit 1996, do të njihet periudha, gjatë së cilës është derdhur kontribut në fondin e sigurimit shtetëror suplementar.

Kanë të drejtë të marrin përfitime shtetërore suplementare presidentët e Republikës, që kanë qenë në këtë funksion prej datës 1 prill 1991. Përfitimet e mësipërme do të jepen që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”. Efektet financiare, për pagimin e këtyre përfitimeve, të përballohen nga buxheti i shtetit.

Procedurat dhe institucionet kompetente për njësimin e funksioneve dhe të pagës referuese, kur emërtimet e funksioneve kanë ndryshuar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Paga referuese, për efekt të llogaritjes së pensionit suplementar, sipas këtij ligji, për deputetët e legjislaturës 1991-1992, që në të njëjtën kohë punonin në funksione dhe detyra të tjera, do të jetë paga referuese e deputetit, në momentin e daljes së tyre në pension.

Neni 16

Kur vitet e shërbimit nuk janë vite të plota, për efekt llogaritjeje të masës së përfitimit, do të llogariten edhe ditët ose muajt mbi këto vite. Mënyra e llogaritjes do të përcaktohet në udhëzimin që do të nxjerrë Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 17

Indeksi

(ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 9061, datë 8.5.2003; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Pensionet shtetërore suplementare indeksohen. Koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17/1

Indeksi i pagës referuese

(shtuar me ligjin nr. 166/2020, datë 23.12.2020)

Paga referuese e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 7 të nenit 1 të këtij ligji, mbi të cilën llogariten pensionet shtetërore suplementare për personat që kanë kryer funksionet e parashikuara dhe të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për funksionet, paga e të cilëve referohet të ligji i sipërcituar, indeksohet sipas indeksit të çmimeve të konsumit deri në datën e lindjes së të drejtës për përfitim.

Procedurat e indeksimit të pagës referuese sipas funksioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Pagesa e pensionit shtetëror suplementar ndërpritet kur personi zgjidhet ose caktohet në funksionet a detyrat e grupit të parë ose të dytë. Në këtë rast, pas përfundimit të shërbimit në funksion a detyrë, pensioni shtetëror suplementar do të rillogaritet.

Neni 19

E drejta për përfitim

(ndryshuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

E drejta për përfitim shtetëror suplementar nuk parashkruhet.

Personit, që kërkon përfitim shtetëror suplementar brenda një viti nga data që i ka lindur e drejta, i jepet ky përfitim që nga kjo datë. Në raste të tjera, përfitimi do të paguhet nga data e regjistrimit të kërkesës.

Përfitimet e njohura nga ky ligj, por të patërhequra, do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se tre vjet.

Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet.

E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se tre vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se gjashtë muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës, për çdo muaj, është 20 për qind e kështit mujor të përfitimit.

Neni 19/1

Të drejtat e fituara

(shtuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Pensionet shtetërore suplementare me datë fillimi deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfshirë edhe këtë datë, caktohen sipas dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi deri në atë datë dhe nuk janë objekt ndryshimi apo rillogaritjeje, përveç indeksimit, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

Personat, që kanë fituar të drejtën për pension shtetëror suplementar në moshën 55 vjeç e lart, do të vazhdojnë të paguhën, pavarësisht se nuk e kanë arritur moshën e përcaktuar në këtë ligj.

Personat, që janë trajtuar me pension shtetëror suplementar dhe e kanë ndërprerë atë për arsye punësimi, kanë të drejtën e rikthimit në skemën e pensioneve suplementare edhe përpara moshës 60 vjeç.

Neni 20

Pensionet shtetërore suplementare administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 21

Kërkesa

Pensionet shtetërore suplementare jepen me kërkesën e të interesuarit, i cili do të paraqesë dokumentacionin përkatës.

Kërkesa për pension paraqitet pranë organeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Dokumentet që i bashkëngjiten kërkesës, përcaktohen me akte nënligjore.

Neni 22

Pagesa e pensioneve shtetërore suplementare bëhet nga organi i caktuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 23

Apelimet kundër vendimeve të përfitimit bëhen në gjykatë e cila e zgjidh çështjen përfundimisht.

Neni 24

(ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Pensioni shtetëror suplementar ndërpritet vetëm me vendim gjykate të formës së prerë dhe, në këtë rast, vendoset edhe për kthimin e kontributeve.

KREU IV DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

(ndryshuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

Pensioni shtetëror suplementar, sipas këtij ligji, përfitohet edhe në rastet kur personi përfiton pension të posaçëm shtetëror, pension nga një skemë tjetër suplementare ose trajtim të veçantë, me kusht që periudhat e shërbimit të mos mbivendosen.

Neni 26

Personi që ka përfituar pension nga ligji për sigurimet shoqërore dhe pas datës 1 prill 1991 është në marrëdhënie pune në funksionet a detyrat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, merr përfitimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 27

Personi, i cili, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë”, përfiton shtesë pensioni dhe në rast se pas datës 1 prill 1991 është në marrëdhënie pune në funksionet a detyrat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, merr përfitimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 28

(shfuqizuar me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999)

Neni 29

(shtuar paragraf me ligjin nr. 8500, datë 10.6.1999; ndryshuar me ligjin nr. 27/2015, datë 26.3.2015)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1, 15 dhe 17 të këtij ligji.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Financave të nxjerrin aktin nënligjor të përbashkët për procedurat e pagimit të kontributeve dhe të përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi më 1 prill 1996.

**Shpallur me dekretin nr.1445, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**